

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6540  
E hënë, 21 shkurt 2022  
çmimi 0.40

## I jepet lamtumira e fundit policit të vrarë aksidentalisht



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## PËR PESË VJET, KATËR NJOHJE



Kosova në pesë vjetët e fundit ka pranuar katër njohje ndërkombëtare. E shpallur e pavarur 14 vjet më parë, Kosova është njohur nga 117 shtete. Gati gjysma prej tyre e kanë njohur në vitin e shpalljes së pavarësisë, më 2008. Njohja e fundit që ka marrë Kosova ka qenë nga shteti i Izraelit, më 1 shkurt 2021. Avni Spahiu, i cili ka shërbyer ambasador i Kosovës në Shtetet e Bashkuara dhe në Turqi, thotë se MPJD duhet të aktivizohet dhe të sigurojë njohje të reja për Kosovën, që do ta fuqizonin subjektivitetin e saj ndërkombëtar

## Ministria e Jashtme hedh poshtë pretendimet ruse për "mercenarët nga Kosova"

FAQE 6



## KURTI SËRISH KËRKON HAPJEN E ARKIVAVE SHTETËRORE TË SERBISË

FAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
+389 44 487 200  
+389 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.PK.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

### AKTUALE



#### RUSIA ËSHTË NË PRAG TË PUSHTIMIT TË UKRAINËS

F. 2

#### OSMANI: SERBIA TË TRAJTOHET SI SHTET QË NUK BAZOHET NË VLERAT EVROPIANE

F. 3

#### KOSOVA REGJISTRON DY VIKTIMA DHE 183 RASTE TË REJA ME COVID

F. 6

### EKONOMI



#### LINJA NËPËR SHKODËR, MË E VOLITSHMJA PËR HEKURUDHËN PRISHTINË - DURRËS

F. 5

#### ATK-ja: EDHE QYTETARËT DUHET TA BËJNË DEKLARATËN TATIMORE PËR TË ARDHURAT PERSONALE DERI MË 31 MARS

F. 7

### SPORT



#### BALLKANI FITON NDAJ PRISHTINËS DHE BËHET LIDER

F. 11



## Rusia është në prag të pushtimit të Ukrainës

UASHINGTON, 20 SHKURT - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, paralajmëroi se bazuar në zhvillimet aktuale, duket se Rusia është “në prag” të pushtimit të Ukrainës. Ai, po ashtu, tha se zgjatja e stërvitjeve ushtarake Rusi - Bjellorusi shton shqetësimet.

Sekretari Blinken tha se presidenti amerikan Joe Biden është i përgatitur që deri në minutën e fundit të takohet me presidentin rus Vladimir Putin, “në çdo kohë dhe në çdo format”. Pas një paralajmërimi që Bideni bëri dy ditë më parë se Putini kishte vendosur tashmë që ta pushtonte Ukrainën, Blinken tha se Uashingtoni do të bëjë gjithçka që mundet për ta penguar Putinin dhe për ta bindur atë që ta ndryshojë vendimin e tij.

Duke folur për CNN më 20 shkurt, Blinken tha se Shtetet e Bashkuara dhe aleatët kanë përgatitur një “pako masive” të sanksioneve ndaj Rusisë, nëse Moska vendos ta pushojë Ukrainën.

Zyrtarët perëndimorë kanë thënë se 150 000 trupa ruse janë grumbulluar afër kufijve të Ukrainës, afro 30 000 të tjera në Bjellorusi dhe mijëra të tjera në rajonet lindore të Ukrainës që kontrollohen nga separatistët që mbështeten nga Moskë.

Ministri bjellorus i Mbrojtjes, Viktor Khrenin, njoftoi se Rusia dhe Bjellorusia po zgjasin stërvitjet e përbashkëta ushtarake, që fillimisht ishte thënë se do të përfundonin



më 20 shkurt për shkak të, siç tha, “rritjes së aktivitetit ushtarak afër kufijve të jashtëm” të Rusisë dhe Bjellorusisë dhe për shkak të rritjes së tensioneve në lindje të Ukrainës.

Blinken tha se nëse vendosen tani sanksione ndaj Rusisë ashtu siç ka bërë thirrje gjatë kësaj fundjave presidenti ukrainas Volodymyr Zelenskiy do ta zvogëlonte efektivitetin e tyre.

Po ashtu, kryeministri britanik Boris Johnson ka paralajmëruar se ShBA-ja dhe Britania do t’ua ndalojnë qasjen kompanive ruse në dollarët amerikanë dhe funtet britanike nëse Kremli vendos që ta sulmojë Ukrainën.

Blinkeni tha se javën e ardhshme planifikon që të takohet në Evropë me ministrin e Jashtëm rus, Sergei Lavrov, nëse deri

atëherë Rusia nuk e pushton Ukrainën.

### Zelenskiy bën thirrje për armëpushim dhe bisedime urgjente për paqe

Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelenskiy, bëri thirrje për “regjim heshtjeje” dhe “shtim” të përpjekjeve

për paqe, pasi presidenti francez zhvilloi biseda telefonike me liderët ukrainas dhe rusë, midis frikës për një pushtim rus të Ukrainës. Zelenskiy, po ashtu, tha se Kievi do të zhvillojë një takim “të menjëhershëm” të ashtuquajturit Grupi Trelateral i Kontaktit, që u formua me qëllim që të gjendet një zgjidhje diplomatike pas nisjes së

konfliktit midis forcave ukrainase dhe separatistëve të mbështetur nga Rusia në lindje të Ukrainës më 2014.

Liderët perëndimorë thonë se Rusia, që ka dislokuar dhjetëra-mijëra trupa afër Ukrainës, përfshirë edhe në Bjellorusinë fqinje, tani po planifikon një sulm të shkallës së gjerë. Moskë mbron se ka plane për pushtim. “Ne jemi për shtimin e procesit të paqes”, tha Zelenskiy përmes një postimi në “Twitter”.

“Ne mbështesim thirrjen e menjëhershme të një takimi të Grupit Trelateral të Kontaktit dhe që menjëherë të vendoset një regjim heshtjeje”, ka shtuar ai.

Këto komente Zelenskiy i bëri pas bisedës që zhvilloi me presidentin francez Emmanuel Macron. Macron, po ashtu, ka biseduar me presidentin rus Vladimir Putin. Pallati Elize tha se kjo bisedë ishte “përpjekja përfundimtare e mundshme dhe e nevojshme për të shmangur një konflikt të madh në Ukrainë”.

Asnjë detaj nuk është bërë publik nga biseda midis Macronit dhe Putinit.

## Rusia dhe Bjellorusia zgjasin stërvitjet ushtarake

Rusia dhe Bjellorusia do t’i zgjasin stërvitjet ushtarake që ishin planifikuar të përfundonin të dielën, më 20 shkurt, tha ministri i Mbrojtjes i Bjellorusisë. Ky njoftim po shihet si rritje e presionit ndaj Ukrainës, derisa liderët perëndimorë po

paralajmërojnë se pushtimi rus është i pashmangshëm. Ministri i Mbrojtjes i Bjellorusisë, Viktor Khrenin, tha se vendimi për zgjatjen e ushtrimeve është marrë “në lidhje me rritjen e aktivitetit ushtarak pranë kufijve të jashtëm” të Rusisë dhe

Bjellorusisë dhe për shkak të rritjes së tensioneve në rajonin Donbas, në lindje të Ukrainës. NATO ka thënë se Rusia ka dislokuar 30 000 trupa në Bjellorusi, të cilat mund të përdoren për sulmin ndaj Ukrainës, edhe pse Moskë mbron se ka plane të tilla.

## Rreth 200 të zhdukur nga vërshimet në Brazil

RIO DE ZHANEIRO, 20 SHKURT - Moti i keq ka penguar kërkimet për të mbijetuarit në qytetin brazilian Petropolis, katër ditë pas vërshimeve shkatërruese dhe rrëshqitjeve të dheut.

Ekipet e shpëtimit ndërprenë disa herë punën gjatë të shtunës për shkak të shirave. Ata thanë se ka pak gjasa që të gjejnë të mbijetuar të tjerë. Zyrtarët thonë se 146 persona kanë vdekur,

përfshirë 27 fëmijë dhe të rinj, ndërkaq 191 persona konsiderohen të zhdukur. Mbi 900 persona janë strehuar nëpër shkolla.

Ekipet e shpëtimit po përdornin lopata për të gërmuar nën dhe pasi, për shkak të kushteve të këqija, nuk po mund të përdorin makineri të tjera.

Në një prej lagjeve më të goditura të Petropolis janë dëmtuar 80 shtëpi.

Vërshimet nisën të martën pas reshjeve të mëdha të shiut, që pritet të vazhdojnë përgjatë shkurtit. Petropolis është një qytet i njohur turistik që gjendet në veri të Rio de Zhaneiro.

Presidenti brazilian Jair Bolsonaro të premten e shpalli këtë zonë të katastrofës dhe tha se qyteti ka përjetuar “shkatërrim të madh, dhe skenat nga atje duken si skena lufte”.





## Kurti sërish kërkon hapjen e arkivave shtetërore të Serbisë

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 20 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, sërish ka kërkuar që Serbia t'i hapë arkivat shtetërore në mënyrë që të zbardhet fati i personave të pagjetur. Ai ka argumentuar se krimet e kryera gjatë luftës së fundit në Kosovë, ishin "krime të kryera nga shteti i Serbisë" dhe theksoi se hapja e këtyre arkivave është domosdoshmëri. Në një panel në Konferencën e Sigurisë në Mynih, ku u diskutua për drejtësinë tranzicionale, Kurti tha se Kosova e ka prioritet drejtësinë tranzicionale.

Në këtë drejtim ai përmendi disa nga nismat që ka ndërmarrë Qeveria e Kosovës siç është ajo për themelimin e

Institutit për Krimet e Kryera Gjatë Luftës, hartimin e Strategjisë Kombëtare për Drejtësi Tranzicionale, themelimin e Komisionit për hulumtimin dhe dokumentimin e trashëgimisë kulturore të shkatërruar gjatë luftës së viteve 1998-1999 dhe fuqizimin e Departamentit të Krimeve të Luftës në Prokurorinë Speciale të Kosovës.

Edhe në të kaluarën Kurti kishte kërkuar që Serbia t'i hapë arkivat shtetërore që të ndriçohet fati i personave të zhdukur gjatë luftës në Kosovë. Duke përmendur Maskrën e Reçakut, Kurti tha se e kaluara nuk ka kaluar ende "përderisa krimet e luftës dhe gjenocidi vazhdojnë të mohohen".

Në dhjetor të vitit 2021 ministri i Punëve të Brendshme i Serbisë,



Aleksandar Vullin, mohoi masakrën e Reçakut, në të cilën u vranë civilë shqiptarë të

Kosovës në janar të vitit 1999. Sipas Fondit për të Drejtën Humanitare, në luftën e fundit

në Kosovë janë vrarë rreth 13 500 persona. Mbi 1 600 konsiderohen ende të pagjetur.

## Osmani: Serbia të trajtohet si shtet që nuk bazohet në vlerat evropiane

EPOKA  
ERE

F. DËRMAKU

PRISHTINË, 20 SHKURT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se Serbia duhet të trajtohet si "shtet që nuk bazohet në vlerat evropiane". Në një tryezë të organizuar në Konferencën për Siguri në Mynih, Osmani tha se ndikimi i Rusisë përmes Serbisë është evident. Sipas Osmanit, Kosova po përballet me një shtet "fqinj agresiv dhe destabilizues". Sipas njoftimit, Osmani tha se është e nevojshme për një përpjekje të bashkërenduar të bashkësisë ndërkombëtare në raport me situatën e sigurisë në Ballkanin Perëndimor.

Në këtë tryezë, ku u diskutua për të ardhmen e Ballkanit

Perëndimor, ku mori pjesë edhe i dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, presidentja Osmani tha se Kosova është e angazhuar në procesin e dialogut me Serbinë që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian dhe se në këtë proces, sipas saj, Prishtina ka dëshmuar konstruktivitet. "Kosova çdoherë ka kontribuar për paqen dhe sigurinë afatgjatë dhe në dialog ka treguar angazhim aktiv duke dhënë propozime konkrete", citohet të ketë thënë Osmani, duke shtuar se procesi duhet të përqendrohet në njohjen reciproke "si e vetmja zgjidhje që siguron paqen dhe stabilitetin afatgjatë në

rajon".

Kosova dhe Serbia kanë nisur dialogun në vitin 2011, por që nga korriku i vitit 2021 kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, si bartës të dialogut, nuk kanë zhvilluar asnjë takim.

Ngecjen në bisedime besohet se e kanë shkaktuar mospajtimet për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. Në vitin 2013 dy vendet kanë arritur marrëveshje për themelimin e këtij asociacioni, por zbatimi i saj ka ngecur.

Kryeministri Kurti thotë se në Kosovë nuk mund të ketë asociacion njëetnik. Serbia, në anën tjetër, insiston në formimin e tij.


## Saranda me një strategji të re për ta mbajtur turistin më gjatë

SARANDË, 20 SHKURT - Sezoni i lartë turistik është duke dhënë sinjalet e para në bregdet dhe hapësirën përreth vijës bregdetare. Këtë vit pritshmëritë janë për një turizëm që nuk ngelet vetëm te profili masiv, por që eksploron edhe thellësitë e territorit, historitë lokale, përvojat, monumentet, jetën në fshat, malet, liqenet, lumenjtë, aktivitetet në natyrë përmes grupeve të vogla të turistëve të aventurës, kulturës dhe ekoturizmit. Kjo qasje e re ka nxitur dy

bashkitë kufitare të Jugut, atë të Sarandës dhe Finiqit, të koordinohen për ta integruar ofertën turistike në funksion të zgjatjes së kohëqëndrimit të vizitorëve në një territor që tashmë e tejkalon Sarandën.

Të dy bashkitë kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi ku në themel janë pajtuar të nxisin një klimë të favorshme për bizneset e turizmit, me fokus tek investimet në informim, inovacion dhe prezantime të ofertës në panairë rajonale dhe ndërkombëtare. Kjo është

hera e parë që flitet për një organizatë të menaxhimit të destinacionit të të dy bashkive në funksion të krijimit të markës dhe rritjes së standardeve. Saranda pret në vit të zakonshëm gati 750 mijë vizitorë të huaj për të cilët oferta ende është e kufizuar në vizita njëditore, ndërsa thellësia e territorit ende është në hapat e parë të investimit në sektorin e turizmit për shkak të nivelit shumë të lartë të emigracionit dhe të mungesës së ekspertizës në turizëm. (TCh)







# Për pesë vjet, katër njohje

**PRISHTINË, 20 SHKURT** - Kosova në pesë vjetët e fundit ka pranuar katër njohje ndërkombëtare. E shpallur e pavarur 14 vjet më parë, Kosova është njohur nga 117 shtete. Gati gjysma prej tyre e kanë njohur në vitin e shpalljes së pavarësisë, më 2008.

Nga vendet e Ballkanit Perëndimor nuk e njeh ende Serbia, e cila me Kushtetutë vazhdon ta konsiderojë si pjesë të vetën e as Bosnjë dhe Hercegovina.

Nga vendet e Bashkimit Evropian nuk e kanë njohur Greqia, Rumania, Spanja, Sllovakia dhe Qipro edhe përkundër faktit se Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ka konstatuar në vitin 2010 se pavarësia e Kosovës “nuk bie ndesh me ligjin ndërkombëtar”. Mosnjohjet, në një mënyrë ose tjetër, e pengojnë Kosovën - nisur nga lëvizja e lirë deri te pranimi në organizata të ndryshme ndërkombëtare.

Në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në Kosovë (MPJD) nuk i janë përgjigjur pyetjes së Radios Evropa e Lirë rreth çështjes së lobimit për njohje.

Në uebfaqen e kësaj ministrie, të pjesa për politikën e jashtme, shkruan se MPJD “mbetet

fuqimisht e angazhuar për të lobuar për njohje ndërkombëtare nga ana e shteteve anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, me qëllim të forcimit të pozicionit ndërkombëtar të Kosovës dhe për të vendosur marrëdhënie diplomatike me shumicën e shteteve anëtare të OKB-së”.

Njohja e fundit që ka marrë Kosova ka qenë nga shteti i Izraelit më 1 shkurt 2021. Kjo njohje ka qenë pjesë e një marrëveshjeje me Serbinë për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike, e nënshkruar në Uashington më 4 shtator 2020, në praninë e presidentit të atëhershëm amerikan Donald Trump.

Para Izraelit, për gati tre vjet Kosova nuk është njohur nga asnjë vend. Për më tepër, ajo është përballur me fushatën e Serbisë për çnjohje. Autoritetet në Serbi kanë thënë se kanë arritur t’i bindin disa vende për t’i tërhequr njohjet e Kosovës, në mesin e tyre: Surinami, Burundi, Liberia, Ishujt Solomon, Madagaskari, Togo, Republika Qendrore e Afrikës, Gana, Siera Leone e të tjera. Autoritetet e Kosovës, megjithatë, nuk kanë konfirmuar ndonjë çnjohje.

Pjesë e Marrëveshjes së

Uashingtonit ka qenë edhe një moratorium njëvjeçar mbi fushatën e Serbisë për çnjohjen e Kosovës ashtu si edhe një moratorium njëvjeçar mbi përpjekjet e Kosovës për t’u anëtarësuar në organizata ndërkombëtare.

Moratoriumet kanë skaduar në shtator të vitit të kaluar dhe nuk është e qartë nëse Serbia ka rinisur fushatën e saj. Po ashtu, nuk është bërë me dije që Kosova ka aplikuar për anëtarësim në ndonjë organizatë të huaj ndërkombëtare.

## Spahiu: MPJD ka stagnuar

Avni Spahiu, i cili ka shërbyer si ambasador i Kosovës në Shtetet e Bashkuara dhe në Turqi, thotë se MPJD duhet të aktivizohet dhe të sigurojë njohje të reja për Kosovën, që do ta fuqizonin subjektivitetin e saj ndërkombëtar. “Në të kaluarën, Ministria e Jashtme ka pasur një program konkret se si t’u qasemi kërkesave për njohje të vendit, por mendoj se ka një stagnim në angazhimin e duhur të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Për fat të keq, po shihet një

neglizhencë”, thotë Spahiu për “Radion Evropa e Lirë”. Sipas tij, fokusi duhet të jetë në pesë vendet e Bashkimit Evropian që nuk e njohin ende Kosovën.

## GLPS: Diplomaci pa strategji

Lirika Agusholli, hulumtuese në Grupin për Studime Politike dhe Juridike (GLPS), thotë se Kosovës i mungon strategjia për sigurimin e njohjeve të reja. “Është nevojë emergjente që të përpilohet një strategji e qartë pro-aktive nga ana e MPJD-së në Kosovë. Duhet të punohet në organizime, vizita zyrtare dhe samite në vendet mosnjohëse, me qëllim të informimit për gjendjen e shtetit të Kosovës”. “Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, ka thënë shumë qartazi, ka shumë punë për të bërë në çështjen e njohjeve të legjitimitetit të shtetit të Kosovës”, thotë Agusholli për “Radion Evropa e Lirë”. Sipas saj, Kosova duhet të ketë lobim intensiv në pesë vendet mosnjohëse të BE-së.

## Kosova kërkon njohje reciproke me Serbinë

Kosova qysh në vitin 2011 është

e angazhuar në një dialog për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë.

Dialogu ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian dhe mbështetet nga Shtetet e Bashkuara. Autoritetet në Kosovë thonë se procesi duhet të përfundojë me njohje reciproke. Megjithatë, e ardhmja e këtyre bisedimeve është e paqartë. Bartësit aktualë të dialogut, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić, nuk janë takuar qysh në korrik të vitit të kaluar.

Një nga mbështetëset më të mëdha të Serbisë në arenën ndërkombëtare, Rusia, e pengon anëtarësimin e Kosovës në OKB.

Kosova ende nuk është as anëtare e Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës, Organizatës Botërore të Tregtisë, Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (INTERPOL) e të tjera. Por, gjatë 14 vjetëve të pavarësisë ajo ka arritur të anëtarësohet në disa organizata ndërkombëtare - në mesin e tyre: Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Komiteti Olimpik, Federata Evropiane e Futbollit dhe Federata Botërore e Futbollit.



# Linja nëpër Shkodër, më e volitshmja për hekurudhën Prishtinë - Durrës

PRISHTINË, 20 SHKURT - Ndërtimi i hekurudhës Prishtinë - Durrës është marrë seriozisht nga qeveritë shqiptare. Të dyja qeveritë, e Shqipërisë dhe e Kosovës, kanë ndarë nga rreth 1 milion euro për studimin e fizibilitetit, për çka edhe u takuan para një jave.

Linja që po përkrahet ka tjetër trase nga ajo më e përfolura, skaj Rrugës së Kombit. Në

pjesën shqiptare hekurudha do të kalojë nëpër Shkodër, për të arritur në Portin e Durrësit. Ndryshime pritet të ketë edhe në Kosovë. "Klinë - Prizren dhe të shkojë pranë Aeroportit të Gjakovës, pastaj do ta përcjellë rrugën ekzistuese për fshatin Ponashec dhe do të shkojë në Qafë të Morinës", shpjegon Xhevat Ramosaj nga komisioni ndërshtetëror për hekurudhën

Prishtinë - Durrës.

Kjo hekurudhë që bashkon Portin e Durrësit me atë të Tivarit në Mal të Zi, sipas Xhevat Ramosajt nga komisioni ndërshtetëror për këtë projekt, është mundësi e mirë për tërheqje të kredive të buta dhe granteve, pasi ka ndikim rajonal.

"Do të kërkojmë fonde nga Bashkimi Evropian që ndahen në formë të granteve", thotë

Ramosaj, njofton Klan Kosova. Projekti që parasheh kosto rreth 700 milionë euro, e fuqizon Portin e Durrësit. Kjo mund t'i prekë interesat e shteteve të tjera në rajon e që mund të dalin kundër. "Greqia sepse fuqizimi i portit të Durrësit do ta eliminonte, ose i bën konkurrencë portit të Selanikut, pastaj i prekë interesat e Italisë, Kroacisë", thotë Gëzim Qerimi, ish-

anëtar i bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave.

Për këtë arsye Qerimi sugjeron që për hekurudhën është më mirë të kërkohet mbështetje financiare nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në kushte optimale, studimi i fizibilitetit përfundon kah fundi i vitit 2023, pas kësaj kohe mund të fillohet gjetja e fondeve për ndërtimin e projektit gjigant.



## I jepet lamtumira e fundit policit të vrarë aksidentalisht

PRISHTINË, 20 SHKURT - Familjarë, zyrtarë të Policisë së Kosovës dhe mijëra qytetarë i dhënë lamtumira e fundit policit të vrarë aksidentalisht, Lirim Haxholli, djalit të vetëm në familje. Lirimi është vrarë të enjten në mbremje në fshatin Zllatar të Prishtinës. Zyrtarët policorë bën nderime duke vënë edhe kurora me lule. Ndërsa toger Zymer Islami i shprehi ngushëllime familjes në emër të stacionit policor qendra.

"Në emër të stacionit policor qendra, ngushëllime gjithë familjes dhe gjithë kolegëve. Lirimi ishte një shëmbëlltëri për Policinë e Kosovës, për kolegë dhe shokë. Stacioni policor qendra në emër të të gjithëve ju shpreh ngushëllime. Në emër të të gjithë pjesëmarrësve kërkoj një minutë heshtje", tha ai. Përndryshe, një zyrtar policor



është arrestuar për vrasjen aksidentale të policit 27 vjeçar në fshatin Zllatar të Prishtinës. Pesë policë të tjerë janë

arrestuar për shkak të rrezikut dhe për 9 zyrtarë të tjerë që ishin të pranishëm është rekomanduar masa e

suspendimit.

Organet kompetente janë duke hulumtuar lidhur me incidentin, ndërsa hetimet

vazhdojnë nga hetuesit e IPK-së në konsultim të vazhdueshëm me prokurorin përgjegjës.



# Ministria e Jashtme hedh poshtë pretendimet ruse për 'mercenarët nga Kosova'

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 20 SHKURT - Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës ka reaguar ndaj deklaratave të ministrit të Jashtëm rus, Sergei Lavrov, dhe raportimeve nga agjencia ruse e lajmeve, TASS, se "mercenarë nga Kosova" po dërgohen në rajonin Donbas të Ukrainës, ku forcat qeveritare ukrainase luftojnë me separatistët e mbështetur nga Moska.

MPJD përmes një njoftimi e cilësoi të "pavërtetë dhe tendencioz çdo pretendim të agjencisë të lajmeve ruse TASS dhe të ministrit të Jashtëm rus, Sergei Lavrov, se kinse 'Kosova dhe disa pjesë të tjera të Ballkanit Perëndimor po bëhen terren për krimin...'".

Agjencia e lajmeve ruse TASS ka raportuar më 18 shkurt se ministri Lavrov kishte deklaruar se Rusia po verifikonte raportimet se "mercenarët nga Kosova, Shqipëria dhe Bosnjë e Hercegovina po dërgohen në

Donbas".

Në reagimin e MPJD-së thuhet se me ligjet në fuqi qytetarëve të Kosovës u ndalohej që të marrin pjesë në luftëra jashtë vendit. "MPJD vlerëson se deklaratat e agjencisë së lajmeve TASS dhe ministrit Lavrov janë pjesë e një fushate të egër të propagandës ruse që kanë për qëllim tërheqjen e vëmendjes së gjithë botës demokratike nga ankthi që po krijon politika hegjemoniste dhe e diktatit rus mbi të drejtat e popujve për jetë të lirë e sovranë", thuhet në reagim.

Sipas MPJD-së, fushata e Rusisë kundër Kosovës dhe shteteve të tjera në Ballkanin Perëndimor, "ndër të tjera, ka për qëllim edhe tensionimin e situatës në Kosovë dhe më gjerë në rajon përmes satelitit rus në Ballkan, Serbisë". MPJD tha se Kosova është në solidaritet me Ukrainën dhe dënon "politikën hegjemoniste dhe ekspansioniste ruse në dëm të shtetit sovran e të pavarur të Ukrainës".

Kosova më herët ka bërë thirrje



që qytetarët e saj që gjenden në Ukrainë të largohen për shkak të rrezikut nga një pushim i mundshëm rus. Megjithatë, MPJD nuk ka treguar se sa është numri i shtetasve kosovarë që ndodhen në Ukrainë.

Shtetet perëndimore kanë shprehur frikën e tyre se Rusia po përgatitet që ta pushojë Ukrainën, pasi ka grumbulluar 190 000 trupa në kufijtë e këtij shteti. Në këtë shifër përfshihen edhe separatistët që

mbështeten nga Ukraina, të cilët për tetë vjet po luftojnë me forcat ukrainase në rajonet lindore Donetsk dhe Luhansk, që njihen me termin Donbas. Rusia mohon se ka plane që ta pushojë Ukrainën.

## SBASHK-u paralajmëron grevë më 2 prill



PRISHTINË, 20 SHKURT - Rritja e çmimeve në produktet bazë për konsum në Kosovë ka bërë që Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës të dalë me një kërkesë për Qeverinë e Kosovës.

Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, në një prononcim për "Telegraf"-in tha se kanë kërkuar që qeveria t'i mbështesë ata me nga 100 euro pasi, sipas tij, pas ngritjes së çmimeve të të gjithë artikujve është varfëruar shporta e punëtorëve të arsimit. "Këshilli Drejtues në mbledhjen e jashtëzakonshme e ka parë të arsyeshme sepse Ligji i Pagave po shihet se ka tendencë të mos bëhet me kohë, nuk dihet se kur do të shkojë në Kuvend për votim. Ne kemi insistuar që pas ngritjes së vazhdueshme të

çmimeve në të gjithë artikujt elementarë, qeveria Kurti t'i mbështesë të punësuarit në sektorin e arsimit me nga 100 euro në pagë. Konsiderojmë se është e udhës që qeveria Kurti të intervenojë t'i ndihmojë punëtorët e arsimit dhe të tjerët me një shtesë prej 100 eurove dhe kjo të vlejë derisa të fillojë implementimi i Ligjit të Pagave pas marrëveshjes me sindikatat. Pagat aktuale janë zbehur tani për shkak të rritjes së vazhdueshme të çmimeve dhe konsiderojmë që qeveria Kurti duhet të intervenojë", u shpreh Jasharaj.

Jasharaj shtoi se nuk do të hasin në bashkëpunim nga qeveria, atëherë më 2 prill do të detyrohen ta fusin në grevë të gjithë sistemin e arsimit në Kosovë.

## Kosova regjistron dy viktima dhe 183 raste të reja me Covid

Prishtinë, 20 shkurt (ER) - Kosova ka regjistruar dy viktima dhe 183 raste të reja me koronavirus, bëri me dije Ministria e Shëndetësisë (MSh) më 20 shkurt.

Rastet e reja dolën pas testimit të 2 787 mostrave. Sipas kësaj shifre, i bie që 6.56 për qind e të testuarve kanë rezultuar me sëmundjen Covid-19.

Në 24 orët paraprake, sipas MSh-së, janë shëruar edhe 713 pacientë.

Raste aktive janë 4 541.

Sa i përket vaksinimit, autoritetet shëndetësore kanë

administruar edhe 579 doza të vaksinës. Deri më tani në total janë administruar 1 807 323 milion doza të vaksinës kundër koronavirusit.

Rreth 70 për qind e pacientëve që kanë humbur betejën me koronavirus javën e fundit në Kosovë kanë qenë të vaksinuar, por kanë vuajtur nga sëmundje të tjera të rënda, thotë Arben Vishaj, drejtor në Klinikën Infektive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Në dhjetëditëshin e fundit, nga data 9 deri më 19 shkurt,



autoritetet shëndetësore kanë konfirmuar 47 viktima nga Covid, sëmundja që e shkakton koronavirusi.

"Pacientët që kanë humbur jetën kanë lënguar më herët nga sëmundje shumë të rënda, siç janë sëmundjet malinje, ose kanë pasur ndërhyrje në zemër, apo kanë pasur çrregullime të mëdha të zemrës", thotë Vishaj.

Kosova, javët e fundit, ka regjistruar shifra të larta të të infektuarve me koronavirus për dallim nga javët e fundit të vitit të kaluar.



# Diplomacia e zbehtë ekonomike e Kosovës



**PRISHTINË, 20 SHKURT** - Në 14 vjet të shtetësisë, Kosova nuk ka arritur të ndërtojë një "diplomaci ekonomike", që do t'i përfaqëson dhe promovonte prodhimet e saj në tregjet ndërkombëtare, thonë prodhues dhe ekspertë të ekonomisë. Sipas tyre, mungesa e këtij promovimi e ka bërë Kosovën skajshmërisht të varur nga importet.

Mbi 4.6 miliardë euro ka qenë vlera e produkteve të importuara në Kosovë në vitin 2021, ndërsa shumë më pak, 712 milionë euro, ka qenë vlera e eksporteve.

Të dhënat e Doganave të Kosovës tregojnë se trendi ka qenë i ngjashëm edhe në vitin 2020: 3.2 miliardë euro importe, 439 milionë euro eksporte.

Prodhimet e huaja në tregun e Kosovës variojnë nga ato ushqimore deri tek ato ndërtimore.

Bashkim Osmani, nga Klubi i Prodhuesve të Kosovës, thotë se

kapacitetet prodhuese për eksport ekzistojnë, por jo edhe angazhimi i shtetit, sipas tij, për t'iu dhënë shtysë atyre në tregun ndërkombëtar.

"Problemi kryesor qëndron te Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës në Kosovë [MPJD]. Nga kjo ministri, përveç ambasadorëve, ka edhe zyrtarë në shtete të tjera që paguhen me taksat tona. Qëllim primar i tyre është ta promovojnë ekonominë e vendit. Në shumicën e rasteve ne as nuk i njohim se kush janë", thotë Osmani për "Radion Evropa e Lirë".

Në MPJD, megjithatë, thonë të kundërtën. Nga Zyra për Informim e kësaj ministrie pohojnë se "misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës janë duke u angazhuar për ndërkombëtarizimin e kompanive kosovare, private dhe publike, e rrjedhimisht edhe për rritjen e eksportit". "Republika e

Kosovës, nga korriku i vitit 2014, ka filluar të ngrejë aftësinë konkurruese të firmave kosovare në sektorë të caktuar për zhvillim të energjisë, industrisë dhe turizmit, të cilat kanë qenë të gatshme t'i plasojnë produktet e tyre në vende të ndryshme të Evropës dhe botës", thotë MPJD në një deklaratë për REL-in.

Në kuadër të MPJD-së ekziston edhe Departamenti për Diplomaci Ekonomike, i cili, siç thuhet, merret me "promovimin e interesit ekonomik kombëtar të Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare".

Bashkim Osmani është edhe pronar i kompanisë "Laberion" në Gjilan, e cila merret me prodhimin e lëngjeve. Kompania e tij eksporton në shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe në ato të Bashkimit Evropian.

Osmani thotë se asnjë produkt i kompanisë së tij nuk është promovuar nga institucionet shtetërore. Sipas tij, shumë

kompani të Kosovës mund t'u bëjnë konkurrencë edhe prodhuesve të vendeve të tjera. "Tashmë ka standarde, ka kuantitet, por ka edhe cilësi... Por, problemi është te mungesa e promovimit të produkteve. Prodhuesve u nevojiten tregje të reja, lobim më serioz, më dinamik nga institucionet e Kosovës", thotë Osmani.

Në uebfaqen e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës në Kosovë reklamohen disa vende turistike dhe një kompani e verës.

Për krahasim, Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme e Shqipërisë, në periudhën korrik 2020 - korrik 2021, ka promovuar 105 produkte shqiptare, apo "Made in Albania". Aty janë të publikuar dy katalogë, ku për secilin nga produktet ka të dhëna, përfshirë adresën e prodhuesit, numrin e kontaktit dhe adresën elektronike.

Profesori i ekonomisë në Kosovë,

Safet Gërzhaliu, thotë se diplomacia ekonomike, në 14 vjet shtetësi të Kosovës, "ka qenë e politizuar" dhe "nuk u ka kushtuar vëmendje interesave të bizneseve". "Kosova sot e ka të vështirë të kompletojë një tryezë me prodhime 'Made in Kosova'. Vetë fakti se edhe grurin e importojmë - sepse nuk ka prodhim për t'i përmbushur kërkesat e qytetarëve - dëshmon më së miri varësinë nga importi", thekson Gërzhaliu.

Vetëm në dy vjetët e fundit Kosova ka importuar nga shtetet fqinje dhe të Evropës miell dhe grurë në vlerë mbi 63.5 milionë eurosh.

Vlera më e madhe e produkteve të importuara në Kosovë janë nga vendet e Bashkimit Evropian, pasuar nga vendet nënshkruese të Marrëveshjes për Tregti të Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA): Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Serbia, Bosnje e Hercegovina, Mali i Zi dhe Moldavia.

## ATK-ja: Edhe qytetarët do të bëjnë deklaratën tatimore për të ardhurat personale deri më 31 mars

**PRISHTINË, 20 SHKURT** - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) nga ky vit ka nisur një aktivitet të ri për mbledhjen e tatimeve për buxhetin e shtetit. Edhe qytetarët sikur bizneset deri më 31 mars do të jenë të detyruar ta bëjnë deklaratën tatimore mbi të ardhurat personale në ATK.

Ky institucion nga ky vit po synon t'i shtojë të hyrat buxhetore për arkën e shtetit përmes shtrirjes së bazës tatimore edhe për qytetarët të cilët realizojnë të ardhura individuale nga aktivitetet e

ndryshme.

Në kuadër të Ligjit për Tatimin në të Ardhurat Personale, drejtori i ATK-së, Ilir Murtezaj, ka bërë me dije se çdo qytetar që realizon një të ardhur personale është i detyruar ta dorëzojë deklaratën tatimore deri më 31 mars të këtij viti.

Në të kundërtën, ndëshkimet për mosdeklarim janë të njëjta edhe për individin sikur për bizneset. Murtezaj thotë për "KosovaPress" se ideja e këtij aktiviteti të ri është që ATK-ja ta shtrijë bazën tatimore edhe te qytetarët.





# Zemërimi i Kristoforidhit



## Hyrje nga Taulant Ceka

Edhe engjëjt zemërohen. Kjo i ka ndodhur engjëllit të Rilindjes Kombëtare, babait të Gjuhës Shqipe, Kostandin Kristoforidhit. Pas 20 vjet rropatje ndër fshatrat e qytetet e Shqipërisë për hartimin e fjalorit të gjuhës shqipe, pasi arriti të mbledhë 400 napolona flori në emër të tij në kolonitë shqiptare të Vllahisë dhe të Misirit, "vëllezërit" shqiptarë të këtyre kolonive, ndërhyjnë në Bankën e Bukureshtit, i marrin 400 florinj të mbledhur në emër të tij për botimin e fjalorit në Rumani dhe i harxhojnë në gosti e gëzime me sebin e themelimit të shoqërive atdhetare. Është një letër drejtuar mikut të tij Nikolla Naco, kryetar i shoqërisë "Drita" të Bukureshtit, ku derdh gjithë mllëfin e grumbulluar për këtë grabitje, me pasojë për kryeveprën e tij, por edhe për trashëgiminë e gjuhës kombëtare. Ashtu si shprehet në letër, fjalori në dorëshkrim ishte një vepër, që do të përbente themelet e gjuhës shqipe, që po rilindte nga thellësitë e shekujve. "Ishte 40 mijë fjalë, i tipit Larousse", shkruan prof. Simon Shuteriqi, botuesi i letrës së tij në kapitullin për Kristoforidhin në historinë e letërsisë shqipe, përgatitur nga studiuesi Namik Resuli. Pas vdekjes së Kristoforidhit, dorëshkrimi i mbetur i pabotuar iu shit nga pasardhësit e Kristoforidhit një botuesi grek, i cili e botoi me 1/4 e vëllimit të tij, në vetëm 11 mijë fjalë në formën e një fjalori shqip – greqisht. Edhe aq, edhe i tillë, ishte i pari fjalor shkencor i gjuhës shqipe hartuar

nga një shqiptar.

Ky fjalor, më shumë se shqiptarëve u shërbeu autoriteteve të njohur të indoeuropianistikës Krecmer, Waigand, Jokli, Pedersen etj. Veç këtij fjalori, sipas dëshmisë së Simon Shuteriqit, Kristoforidhi kishte mbledhur lëndë leksikore, faqe të tëra me fjalë në gjuhët sanskrite, greke, latine, sllave, turke, që kanë hyrë në gjuhën tonë, me qëllim hartimin e një fjalori etimologjik të gjuhës shqipe. Këto dorëshkrime, deri në vitin 1945 kanë qenë pjesë e trashëgimisë arkivore të Lef Nosit.

## Kostandin Kristoforidhi

Drejtuesi Nikolla Nacos, kryetarit të shoqërisë "Drita", në Bukuresht. Zoti i nderçëmë Nikolla Naco, në Bukuresht! Kartën e Zotërisë sate shkruarë mbë 16 të vjeshtës së tretë e prita me gaz të madh; bashkë me atë mora edhe tetë kora (Ikona, harta T. C.) të Shqipërisë për t'i përndarë, po ato dhjet abetare që më shkruan se po t'i dërgonj, s'më kanë rënë në dorë ngjer mbë sot, as kanë për të më rënë, sepse mirretë vesh se i ka ndaluarë gjymryku (dogana, turq. T. C.) i Stambollit, a gjymryku i Selanikut. Zotëria jote, kur do të më shkruajsh, a të më dërgosh ndonjë vivle (libër, T. C.), a tjetërë gjë, të m'i dërgojsh me anë të Trieshtesë nga Austria me udhë të hekurit, që të dalenë në Durrës të Shqipërisë pas adresësë që po ta mbyll brenda në kartet t'ime. Sot shtatë tetë vjet, kur qeshë unë sëmurë në Stamboll, dërgova Jano Vretonë në Vllahit e në Misir

për të kërkuarë ndihmë mb'emërit t'im, që të shtypetë leksikoja (fjalori, gr. T. C.) e gjuhësë shqipesë, që jam munduarë 20 vjet për atë punë edhe kam mbledhurë 40 000 fjalë shqip; edhe u mbëllohnë katërëqind napoleona t'arte mb'emërit t'im; edhe u vunë në Bankët të Bukureshtit, sepse nuk dilin aqë para për të shtypurë leksikone; atëherë pa pyeturë mua, pa shkruarë mua, pa dhënë zë mua, vëllezërit t'anë Shqipëtarëtë që gjendenë në Misir bashkë me vëllezërit t'anë që gjendenë në Vllahi, ngrehnë shoqërinë e shqipesë në Bukuresht edhe bënë dasmë e gosti e gëzim të math, dhe thërritnë bij e bija, vëllezër e motëra, nipër e mbesa, kushërinj e kushërira, miq e miqësi, por kryet e punesë tanë, e gjuhësë shqipesë nuk e ftuanë, po ç'bënë ata? Muarnë ato para që qenë mbledhurë mb'emërit tim, për të shtypurë leksikone, edhe shtypnë ca vivlia shqip, ato që kanë shtypurë ngjer mbë sot; zunë të bëninë mur, pa vënë themeli më përpara. Nuk menduanë ata vëllezër të bekuarë, se muri pa themeli nukë qëndron, por rëzonet e shembet e bie përdhe? Nuk e zunë kalinë nga freri, po nga bishti, që shpëton e ikën. Shqipëria ka shumë njerës të diturë, që kanë kënduarë në Elladhë e në Evropë edhe duanë të shkruajnë vivlia Shqip, po nuk e dinë Shqipëni mirë, sepse Shqipeja është më e gjerë edhe më e thellë së Gërqishteja, që flitetë sot; këta njerës të diturë presenë të shtypetë leksikoja e Shqipesë, që të mësojenë mirë gjuhën e Shqipesë, edhe të zenë e të shkruajnë gjithëçfarë vivliash Shqip,

përandaj thashë përpara, se zunë të ngrehenë shtëpi pa vënë më përpara themeli'. Desha t'u flas juve shumë fjalë, edhe t'u shkruan juve për shumë punëra, sepse unë jam i rrahur e i djegur e i pjekur e fort i stërviturë në punët të Shqipesë, edhe kam 20 vjet që po shkruan gjithënjë gjuhën e Shqipesë, edhe kam shtypurë përmbi njëzet copë vivlia Shqip gegërisht e toskërisht, po s'janë fjalë që të shkruhenë të gjitha në kartë, ne paça fat të vinj në Bukuresht, atëherë dot'ua them gojë më gojë. Përmbi gjithë këto, sido të jetë puna, ashtu qoftë, neve këtu në Shqipërit kemi dëgjuar e kemi marrë vesh se Shoqëria e Shqipesë që që ngrehurë në Bukuresht, sot gjendet ndarë dyshe, edhe çë kanë gjajtur e çë kanë koditur e çë kanë bërë ndër vëllezërit, se si e se qysh, të tëra i kemi kupëtuar e i kemi dëgjuar e i kemi marë vesh, edhe e dimë se janë ngrehurë dy shoqëri në Bukuresht, njëra quhetë Dritë e tjetëra Dituria, edhe e dimë se njëra shoqëri vete kundër shoqërisë tjetërë, edhe e dimë se Dituria do të shkruhenë vivlia me Alfavitën e Jano Vretosë që janë gjysëmat e shkronjavet Gërqisht e gjysëmate Llatinisht, edhe duanë që të hapenë skolira ndëpër gjithë Shqipërinë nga shqipëtarëtë vetëmë, e të mos përzihetë tjetërë komb mb'ato; po shoqëria e Dritësë do të shkruhenë vivlia shqip me Alfavitën Llatinisht, edhe duanë që të hapenë skolira shqip në Shqipërit me anë të Rumunëve e me ndihmë të Vllahëve. Ndë më pyetshi mua, unë pëlqej më fort Alfavitën llatinisht, sepse me atë Alfavitë mund të shtypenë vivlia shqip kudo, sepse gjendenë mbë çdo

vent që të kërkojsh, edhe është një Alfavitë i kuptuar e i njohur nga të tërë kombet e Evropësë, po ndë dashtë njeri të shtypë ndonjë vivle shqip me Alfavitën e Jano Vretosë, nuk i gjen ato shkronja as mbe ndonjë vënt, po gjan të derthnë shkronja të ra e të prishnë dy tre qind lira t'arta; edhe ajo që do Shoqëria e Dritësë të hapenë skolira në Shqipërit me anë të Rumunëve e me ndihmë të Vllahëve, nuk më duketë se është keq për Shqipëtarëtë, sepse Shqipëtarëtë vetëmë s'mund të hapenë skolira, përveç kësaj Vllahëtë s'kanë ndonjë sy të lik, a ndonjë mendje të keqe për Shqipëtarëtë, sikundër kanë Greqëtë që duan të pushtojnë e të urdhërojnë Shqipërinë, po edhe ndë pacinë Vllahëtë një të tillë mendie s'mund ta nxjerrin në krye, as s'mund ta bënë dot, sepse kanë ndë mest Bullgarin e Maqedhoninë, që ndan Rumaninë nga Shqipëria, përandaj s'kam ndonjë frikë nga Rumunëtë, sa kam nga Greqëtë që janë fëqinjë me Shqipërinë, edhe po përpiqenë me natë e me ditë qysh t'i bënë për vete. Po e mbyll brenda në kartët adresënë t'ime qysh të më shkruani, edhe të ma dërgoni kartënë me anë të Trieshtesë nga Austria me udhë të hekurit edhe m'u përgjigj pa menuarë kohënë që poqe për t'ardhurë ndë Bukuresht, të bënë gati e të vinj e ndë mos, të më shkruani shpejt, që të vështronj punën time. Të falem me shëndet e të përqafoj vëllezërisht. U falem me shëndet gjithë vëllezërit që gjendenë në Bukuresht Un' i dashuri miku juaj Kostandin Kristoforidhi Elbasanasi



# Shtatë teoritë kryesore mbi origjinën e jetës në Tokë



## Gjithçka nisi pas një shkëndije elektrike

Një goditje rrufeje mund të ketë siguruar shkëndijën e nevojshme për fillimin e jetës në Tokë. Shkëndijat elektrike mund të gjenerojnë aminoacide dhe sheqerna nga një atmosferë e ngarkuar me ujë, metan, amoniak dhe hidrogjen. Kjo gjë është provuar në eksperimentin e famshëm Miler-Urej në vitin 1952.

Gjetjet e atij eksperimenti sugjeruan se rrufeja mund të ketë ndihmuar në krijimin e blloqeve kryesore të ndërtimit të jetës në Tokë. Dhe përgjatë miliona viteve, mund të formohen molekula më të mëdha dhe më komplekse. Edhe pse kërkimet kanë zbuluar se atmosfera e hershme e Tokës ishte në të vërtetë e varfër me hidrogjen, shkencëtarët kanë sugjeruar se retë vullkanike në atmosferën e hershme mund të kenë pasur prani të metanit, amoniakut

dhe hidrogjen, dhe se ato mund të jenë goditur nga rrufetë.

## Molekulat e jetës u ndeshën me njëra-tjetrën në argjilë

Kjo ide është propozuar nga kimisti organik Aleksandër Graham Kairns-Smith në Universitetin e Gllasgout në Skoci. Ai propozoi në librin e tij të diskutueshëm të vitit 1985 "Shtatë të dhëna për origjinën e jetës", se kristalet e argjilës e ruajnë strukturën e tyre, ndërsa rriten dhe ngjiten së bashku për të formuar zona të ekspozuara ndaj mjediseve të ndryshme, duke bllokuar rrugës molekula të tjera, të cilat i organizuan në modele që ishin shumë të ngjashme me gjenet tona sot. Gjithsesi kjo teori nuk pranohet gjerësisht nga komuniteti shkencor.

Jeta filloi në kanalet hidrotermale në fundin e deteve Sipas revistës "Nature Reviews

Microbiology", kjo teori sugjeron se jeta mund të ketë filluar në kanalet hidrotermale të thellësisë së detit që nxjerrin elementë kyç të jetës, si karboni dhe hidrogjeni. Këto burime mund të gjenden në thellësitë më të errëta të dyshemeve të oqeanit, zakonisht në pllaka kontinentale të ndryshme. Edhe sot këto burime të pasura me energji kimike dhe termike, bartin shumë ekosisteme të gjalla.

## Filloi në vende shumë të ftohta

Akulli që mund të ketë mbuluar oqeanet 3 miliardë vjet më parë, e ka lehtësuar lindjen e jetës. "Përbërjet organike kryesore që mendohet të kenë qenë të rëndësishme për origjinën e jetës, janë më të qëndrueshme në temperatura më të ulëta" tha për "New Scientist" eksperti Xhefri Bada nga Universiteti i Kalifornisë. Po ashtu akulli mund t'i ketë mbrojtur përbër-

jet organike të brishta nga drita ultravjollcë dhe nga shkatërrimi si pasojë e ndikimeve kozmike. Përgjigja qëndron në të kuptuarit e formimit të ADN-së. Në ditët e sotme ADN-së i duhen proteina për t'u formuar. Dhe proteinat kërkojnë ADN për t'u formuar. Atëherë si mund të jenë formuar ato pa njëra-tjetrën? Përgjigja mund të jetë ARN, e cila mund të ruajë informacione si ADN-ja, të shërbejë si një enzimë ashtu si proteinat, dhe të ndihmojë në krijimin e ADN-së dhe proteinave. Më vonë ADN-ja dhe proteinat e pasuan këtë "botë të ARN-së", pasi ato janë më efikase.

## Jeta në Tokë ka pasur fillime të thjeshta

Në vend se të jetë zhvilluar nga molekula komplekse si ARN, jeta në Tokë mund të ketë filluar me molekula më të vogla, të cilat ndërveprojnë me njëra-tjetrën në reaksione ciklike. Ato

mund të jenë përfshirë në kapsula të thjeshta të ngjashme me membranat qelizore, dhe me kalimin e kohës mund të kenë evoluar në molekula më komplekse që kryenin këto reaksione më mirë se ato më të voglat.

## Jeta u soll në Tokë nga një vend diku tjetër në hapësirë

Ndoshta jeta nuk filloi fare në Tokë, por u soll këtu nga diku tjetër në hapësirë, një koncept që NASA e njeht si panspermia. Për shembull, shumë shkëmbinj shpërbëhen vazhdimisht në Mars si pasojë e përplasjes së trupave qiellorë. Një numër meteoritësh marsianë janë gjetur në Tokë. Disa studiues kanë sugjeruar se ato kanë sjellë këtu bakteret e para. Ndërsa shkencëtarët të tjerë sugjerojnë se mund të ketë udhëtuar për një kohë të gjatë nëpër kometa nga sisteme të tjera yjore. / LiveScience – Bota.al



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Ballkani fiton ndaj Prishtinës dhe bëhet lider

PRISHTINË, 20 SHKURT - Të dielën janë zhvilluar tri ndeshjet e fundit të javës së 20-të në BKT Superligën e Kosovës në futboll. Ballkani ka shënuar fitore si mysafir në derbin e javës kundër Prishtinës. Ndeshja e zhvilluar në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë është mbyllur me rezultat 2-0, në të mirë të skuadrës nga Suhareka. Kjo fitore ia mundësoi Ballkanit që të ngjitet në vendin e parë me 39 pikë, aq sa ka edhe Gjilani në pozitën e dytë. Të dy golat skuadra e drejtuar nga trajneri Ilir Daja i realizoi në minutat shtesë. Ermal Krasniqi realizoi nga penalltia, kurse më pas Mevlan Zeka e vendosi rezultatin përfundimtar pas një kundërsulmi të shpejtë. Prishtina pati mundësi për të shënuar në minutën e 57-të, por Besnik Krasniqi



nuk u tregua i saktë nga penalltia. Të dyja skuadrat e mbyllën ndeshjen me nga një lojtar më pak në fushë pas përjashtimit të Lumbard Dellovës (56'), përkatësisht Otto John (70'). Ndërkohë, Gjilani ka shënuar fitore të pritur në duel me Feronikelin në stadiumin "Rexhep Rexhepi", me rezultat 3-1. Blerim Krasniqi (9'), Arbër Prekazi (80') dhe Edison Kqiku (82') realizuan golat për gjilanasit, derisa golin e nderit për Feronikelin, i cili edhe në këtë ndeshje u paraqit me junior, e realizoi Ibrahim Cervadiku. Fitore të rëndësishme ka shënuar edhe Drenica, e cila e ka mundur Dukagjinin në Klinë, me rezultat 2-1. Të dy golat kuqezinjët e Skenderajt i realizuan në pjesën e parë nëpërmjet Baton Zabërgjës (5') dhe Armend Abazit (44'). Ndërkaq, golin e vetëm për Dukagjinin e realizoi Donart Hasanaj. Drita dhe Llapi kanë bërë

njërin prej paraqitjeve më të mira të këtij edicioni në stadiumin e qytetit në Gjilan, teksa në fund kanë marrë nga një pikë (1-1). Llapjanët shënuan të parët nëpërmjet Valmir Veliut, në minutën e 40-të, por Drita arriti të barazojë shifrat në pjesën e dytë, me golin e Ardian Cuculit, nga penalltia e akorduar pas rishikimit në VAR, në minutën e 77-të. Nga një gol e kanë realizuar edhe Ulpiana dhe Malisheva në duelin e zhvilluar në stadiumin "Sami Kelmendi" në Lipjan. Marclei Santos shënoi nga pika e bardhë në minutën e 20-të për Ulpianën. I njëjti futbollist pati mundësi ta dyfishojë epërsinë në minutën e 41-të sërish nga penalltia, por nuk u tregua i saktë. E dy minuta më pas mysafirët barazuan me golin e Xhevdet Shabanit. Malisheva mban pozitën e shtatë në renditje, me 23 pikë, derisa Ulpiana një pozitë më poshtë ka 19 pikë.

### SHKURT

#### Muriqi shënon sërish në La Liga

Sulmuesi i Përfaqësues së Kosovës, Vedat Muriqi ka vazhduar me paraqitje të mira në La Liga me skuadrën e tij të re, Mallorca. Muriqi realizoi të dielën kundër Real Betisit në ndeshjen e javës së 21-të të elitës së futbollit spanjoll. Sulmuesi "dardan" e shënoi golin e barazimit të përkohshëm në minutën e 75-të të ndeshjes, me gjuajtje me kokë. Megjithatë, goli i tij nuk i mjaftoi Mallorcës për të marrë rezultat pozitiv, ngase në fund Real Betis triumfoi 2-1. Ky ishte goli i dytë i Muriqit në La Liga, pasi ka shënuar edhe kundër Cadizit në fitoren 2-1, derisa kundër Athletic Bilbaos asistoi në fitoren 3-2. Mallorca pas 24 ndeshjeve të luajtura ka 26 pikë dhe pozicionohet në vendin e 16-të.

#### Celina shënon në fitoren e Ipswichit

Edhe futbollisti tjetër i Kosovës, Bersant Celina e gjetur rrugën e golit kë në League One të Anglisë. Mesfushori dardan ka shënuar gol në minutën e 78-të të ndeshjes, dhjetë minuta pas inkuadrimit në lojë, derisa skuadra e tij Ipswich fitoi 3-0 ndaj Burtonit. Për Celinën ky ishte goli i pestë në këtë edicion në nivelin e tretë të futbollit anglez. Pas kësaj fitoreje Ipswichi pozicionohet në vendin e 9-të me 51 pikë.

#### Rashica realizon golin e parë në Premier Ligë

Sulmuesi anësor i Përfaqësues së Kosovës, Milot Rashica, e ka realizuar golin e tij të parë në Premier Ligë dhe atë pikërisht ndaj gjigantit anglez, Liverpool. Rashica shënoi në minutën e 48-të, pas një gjuajtje nga distanca, e cila u devijua nga mbrojtësi Joel Matip. Megjithatë, ky gol nuk i mjaftoi skuadrës së Rashicës, Norwich City për të marrë rezultat pozitiv në këtë ndeshje, pasi në vazhdim Liverpooli e përmbysi rezultatin me golat e Sadio Mane, Mohamed Salah dhe Luis Diaz.

#### Ejupi njofton për kandidaturën e tij për president të FFK-së

Presidenti aktual i FC Prishtinës, Remzi Ejupi e ka konfirmuar kandidaturën e tij për president të Federatës së Futbollit të Kosovës. Ai deklaroi se është duke punuar rreth një plani i cili fillimisht do t'u prezantohet klubeve, para kuvendit zgjedhor të FFK-së. "Jemi duke punuar një plan me ekip ndërkombëtar. Do te prezantohet para klubeve. Do te mundohemi të vendosim kriteret, standardet, se kush ka të drejtë", ka thënë Ejupi në "Dueli Sportiv". Ditë më parë, Remzi Ejupi konfirmoi e nuk do të kandidojë më për postin e presidentit të Prishtinës.

**SUPERLIGA - Java e 20-të**

Prishtina-Ballkani	0-2
Feronikeli-Gjilani	1-3
Dukagjini-Drenica	1-2
Ulpiana-Malisheva	1-1
Drita-Llapi	1-1

**Tabela**

1. Ballkani	39 pikë
2. Gjilani	39
3. Drita	38
4. Llapi	33
5. Drenica	27
6. Prishtina	24
7. Malisheva	23
8. Ulpiana	19
9. Dukagjini	18
10. Feronikeli	11

## Prishtina mbetet e pamposhtur, triumfon në derbi ndaj Penzës

PRISHTINË, 20 SHKURT - Prishtina ka shënuar fitore ndaj Penzës në udhëtim me rezultat 82:87 (20:22, 22:21, 21:23, 19:21), në xhiron e 15-të të Superligës së Femrave. Çereku i parë ishte i baraspeshuar, ku epërsinë më të lartë e kishin prishtinaset, gjashtë pikë, 12:18 dhe 16:22, megjithatë, katër pikë në fund nga pejanet bënë që kjo pjesë të përfundojë 20:22. Edhe periudha e dytë u karakterizua si shumë e baraspeshuar, pa arritur shkaputjen e madhe asnjëra skuadër, ndërsa shkuan në pushim me shifrat 42:43. Bardhekaltret e nisën më mirë periodën e tretë, duke pasur epërsi në nëntë pikë, 49:58, megjithatë, vendaset rikthehen shpejt për të barazuar shifrat në 58:58, kurse rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 63:66. Por, në dhjetë minutat e fundit dhe vendimtare, skuadra e Prishtinës ishte në epërsi konstante



për të mos e rrezikuar fitoren dhe duke triumfuar me shifrat 82:87, çka ishte fitorja e 15-të në po aq ndeshje të zhvilluara, kurse pejanet kanë 11 fitore e katër humbje. Te Penza u dalluan Valbona Bytyqi me 23 pikë e 11 kërcime, Rael Whitsitt me 13 pikë e 13 kërcime, Jeta Zeka me 16 pikë dhe Narlyn Mosquera me 18 pikë e nëntë kërcime, kurse te Prishtina u dalluan Arbnore Përquku me 23 pikë, nëntë kërcime e dhjetë asistime dhe Agnesa Rrahmani me 26 pikë e

shtatë kërcime. Ndërkohë, në ndeshjet tjera, Bashkimi ka shënuar fitore ndaj Trepçës me rezultat 71:47 (15:5, 21:7, 22:18, 13:17), ku prizrenaset ishin më të mira nga fillimi deri në fund për të shënuar fitore të merituar. Te skuadra prizrenase u dallua D'asia Chambers me 18 pikë e tetë kërcime, kurse te ajo mitrovicase Kelly Santos me dhjetë pikë e dhjetë kërcime. Bashkimi ka dhjetë fitore e pesë humbje, ndërkohë, Trepça ka pesë fitore e dhjetë humbje. Vëllaznimi ka mundur Kastriotin me shifrat 117:53 (23:16, 27:3, 38:15, 29:19). Te skuadra kuqezi u dallua kapitenia Rina Hoda me 25 pikë, tetë kërcime, 20 asistime dhe 12 topa të vjedhur, ndërsa te skuadra ferizajase u dallua Anita Grainca me 29 pikë e 22 kërcime. Vëllaznimi ka katër fitore e 11 humbje, ndërsa Kastrioti numëron 15 humbje në 15 ndeshje.



## PROTESTË!

*Proteston, refuzon, mallkon, pena e shkrimtarit:  
Kur burgosen çlirimtarët, burgoset edhe  
populli!  
Kur burgoset UÇK-ja, burgoset edhe liria!*




*“Hero në luftë, Hero në paqe” – 1*



*“Drenica para gjyqit” – 2*



*“UÇK-ja para gjyqit” – 3*



*“Na e ban hallall, Kosove” – 4*



*“Edhe malet janë Kosova para gjyqit,  
UÇK - 5*



*dramë, 6*



*Murtaja e Kuqe-7*

(Këta janë 7 libra publicistikë, të botuar nga Riza Greiçevci për Gjykatën Speciale të Hagës, ku po gjykohen: UÇK-ja, çlirimtarët, Drenica, liria, dëshmorët, pushka e Adem Jasharit, Kosova...!)





Shqiptarët Humanitarë Bëmërisë e Kosovës "Mëta Teresa"  
The Kosovo Humanitarian and Charitable Society "Mother Teresa"  
Humanitarino Dobrotvorno Udruzenje Kosova "Majka Teresa"  
10000 Prishtinë, Rr. ULPIANA U1/1 ps. Tel:00381 38 542 864, Fax: 542 869,  
Web site: www.mthersociety.org e-mail: mthersoc@yahoo.com

## CONTRACT AWARD NOTICE SERVICES

According to Article 41 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092

Date of the preparation of the Notice: 18/02/2022

Procurement No	Training	001	2022	221
----------------	----------	-----	------	-----

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

English

### SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY

#### I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)

Official name: Kosovo Humanitarian Charitable Society "Mother Teresa"		
Postal address: str. Mujë Krasniqi n.n. Ulpiana U1/1		
Town: Prishtina	Postal code: 10000	Country: Kosovo
Contact point(s): Zef Shala		Telephone: 044-128-277
Email: zefshala@hotmail.com		Fax: 038-542-865
Internet address (if applicable):		www.matherteresasociety.org

### SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT

#### II.1) DESCRIPTION

II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority:  
Training on Entrepreneurship and self-employment for 560 participants -New beneficiaries  
(Returnees and people at risk of illegal emigration)

II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance  
(Choose one category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)

<input type="checkbox"/> Works	<input type="checkbox"/> Supplies	<input checked="" type="checkbox"/> Services
Main place of performance All Kosovo according to the Request of Contracting Authorities		

II.1.4) Short description of the object of the contract  
Training on Entrepreneurship and self-employment for 560 participants -New beneficiaries  
(Returnees and people at risk of illegal emigration)

II.1.5) Common Procurement Vocabulary classification (CPV)

Standard Form "Contract Award Notice"

1

93.000.000.-8

II.1.6) Division into lots NO

II.1.7) Contract value: 116,200.00

### SECTION III: PROCEDURE

#### III.1) TYPE OF PROCEDURE

Open

#### III.2) AWARD CRITERIA

Lowest price

#### III.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION

#### SECTION IV: AWARD OF CONTRACT

(In case of some parts given to some successful economic operators, repeat S IV.4 and IV.5 for each lot)

IV.1) Date of contract award	18/02/2022	
IV.2) Intended date of contract signing	01/03/2022	
IV.3) Number of received tenders	5	
IV.4) Name and addresses of economic operator to whom the contract has been awarded		
Official name:	D&D Business Support Centre L.L.C	
Postal address:	10000 Prishtinë	
Town: Prishtinë	Postal code: 10000	Country: Kosovo
URL (if applicable):		
Contact point(s): Drilona Selmani	Email: info@dd-bsc.com	
Telephone: +38338748701	Fax: +38338748701	

#### IV.5) Information on value of contract

Total final value of contract 116,200.00 Euro  
Responsive tender with lowest price: 116,200.00 Euro  
Responsive tender with highest price: 156,800.00 Euro

IV.6) The contract is likely to be subcontracted

No

### SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION

#### V.1) COMPLAINTS

Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092, at the address specified in Section I of this Contract award notice.

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Kompania "OSKOS" L.L.C. me seli në Prizren ka marrë vendim të shuaj biznesin me numër të regjistrimit: 811385922 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore-Debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30-ditorë nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavještamo sve klijente da Tvrtka "OSKOS" D.O.O. u Prizren doneo odluku da ugasi biznis po br. registra: 811385922 I ujedno imenovao Likfidatora o sprovođenju postuaka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze I potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform all clients that the Company "OSKOS" L.L.C. based in Prizren has taken the decision to terminate the business with registration number: 811385922 and has appointed the liquidator to conduct the Liquidation procedure. All clients who have the mortgager-mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Zejniha Maloku shpalle të pavlefshme dëftesën e klasës së 9-të të shkollës fillore "Andon Zako Çajupi".
- ▶ Arben Durmishaj shpall të pavlefshme dëftesën dhe diplomën e SHMLM "Dr. Xheladin Deda".
- ▶ Vildane Hoxha shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e "Dr. Xheladin Deda".
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

